



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 56
Prishtinë, më datë 09 shkurt 2010, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

**I M B L E D H J E S S Ë K O M I S I O N I T T Ë S H Ë N D E T Ë S I S Ë, T Ë P U N Ë S
D H E T Ë M I R Ë Q E N I E S S O C I A L E**

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Teuta Hadri, Gjylnaze Sylja, Qamile Morina, Flora Brovina, dhe Bujar Bukoshi .

Munguan : Mursel Halijli, dhe Nurishahe Hulaj.

Të pranishëm: Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit, Shpresa Haxhijaj - administratore , Rrezarta Ahmeti – KDI dhe Petrit Hysa – OSBE, Nexhat Shatri – zyra e presidentit.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt. 02.02.2010;**
- 3. Miratimi i rekomandimeve lidhur me kërkesat e punëtorëve shëndetësorë për rritjen e pagave, miratimin e Ligjit të punës dhe Ligjit për sigurime shëndetësore;**
- 4. Të ndryshme**

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12 janar 2010

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 2 shkurt 2010, pa vërejtje.

3. Miratimi i rekomandimeve lidhur me kërkesat e punëtorëve shëndetësorë për rritjen e pagave, miratimin e Ligjit të punës dhe Ligjit për sigurime shëndetësore;

Sadik Idriz – Si jeni të informuar javën e kaluar Komisioni ka mbajtur një mbledhje të përbashkët me sindikatën e shëndetësisë dhe me ministrin e shëndetësisë dhe ministrin e punës. Në këtë pik të rendit të ditë do ti miratojmë rekomandimet nga mbledhja e kaluar . Pasi mbledhjen e kaluar e ka udhëhequr zëvendëskryetarja e ftoj që ta njoftoj komisionin me rekomandimet e propozuara.

Rita Hajzeraj – Ne kemi shqyrtuar në mbledhjen e kaluar kërkesat e punëtorëve shëndetësor që kanë qen për rritjen e pagave dhe për miratimin e ligjit për sigurime shëndetësore dhe ligjit të punës. Komisioni njëzëri është pajtuar për ta mbajtur atë mbledhje në të cilin kanë qen të ftuar përfaqësuesit e sindikatës së pavarur të QKUK së, përfaqësuesit e Federatës së Sindikatës së Shëndetësisë dhe ministri i shëndetësisë e ministri i punës dhe mirëqenies sociale.

Kërkesat e punëtorëve shëndetësor kanë qen shumë të qarta dhe komisioni fuqishëm i ka përkrahur në mbledhjen e kaluar. Komisioni njëzëri është pajtuar që nga ajo mbledhje të nxjerrin disa rekomandime dhe tu dërgohen institucioneve qeveritare.

Kemi përgatitur edhe propozimet për këto rekomandime që janë :

- 1. Komisioni i përkrah kërkesat e punëtorëve shëndetësore për rritje të pagave dhe për miratimin e Ligjit për sigurime shëndetësore dhe Ligjit të punës.*
- 2. Kërkohet nga Qeveria e Kosovës që në bashkëpunim me ministrin përkatës të gjej një zgjidhje sa më të shpejt për plotësimin e kërkesave të punëtorëve.*
- 3. Të bëhet rritja e pagave të punëtorëve shëndetësor brenda mundësive buxhetore ashtu si ju është premtuar*
- 4. Të sillen në Kuvend në kohën e paraparë sipas strategjisë legislative ligji për punën dhe ligji për sigurime shëndetësore.*

Unë pajtohem me 4 rekomandimet e propozuara por propozoj që nga rekomandimi i tretë të fshihet fjalia „ brenda mundësive buxhetore” dhe të mbetet vetëm „Të bëhet rritja e pagave të punëtorëve shëndetësor ashtu si ju është premtuar”

Flora Brovina – Nga mbledhja e kaluar janë nxjerrur edhe këto propozimrekomandime. Të gjitha rekomandimet që janë përkrahur në mbledhjen e kaluar janë të përfshira në këtë propozim. Prandaj unë pajtohem që ky propozim me këto 4 rekomandime të votohet.

Teuta Hadri – Nga diskutimet në mbledhjen e kaluar u pa që edhe ministri i shëndetësisë ishte i pajtimit për rritjen e pagave të punëtorëve shëndetësor por nuk e tha çart se kur do të ndodh rritja, a do të ndodh nga 1 janari i këtij viti. Çështja e miratimit të ligjeve, është çështje e Qeveris dhe Qeveria do ti sjell ligjet në Kuvend sepse është e interesuar që sa më par të miratohen këto ligje . Ne të fokusohemi vetëm te rekomandimet për rritjen e pagave.

Gjylnaze Sylja – Shpreh dy shqetësime , shqetësimi i par ka të bëj me gjendjen aktuale në sektorin e shëndetësisë , ndërsa shqetësimi i dytë është mosinteresimi i Qeveris për punëtorët shëndetësor dhe mungesa e zëvendëskryeministrit Kuqi në mbledhjen e komisionit që është injorim i kërkesave të punëtorëve shëndetësor. Pajtohem me 4 rekomandimet e propozuara. Si Komision nuk e kemi trajtuar edhe një kërkesë tjetër që ka qen për statusin e veçantë të QKUK-së . Konsideroj se duhet të futen edhe dy pika tjera në këtë rekomandim, pika një që,, statusi i QKUK-së duhet të jetë pjesë e një reforme të përgjithshme të shëndetësisë”, dhe pik e dytë që „Qeveria ta informon me shkrim Komisionin për realizimin e këtyre pikave”.

Qamile Morina – Situata në shëndetësi është e rënd dhe qasja e Qeveris duhet të jetë serioze. Mungesa e zëvendëskryeministrit në mbledhjen e kaluar ka dhënë një sinjal se situata në shëndetësi nuk merret me seriozitet nga Qeveria. Unë kam përgatit edhe një propozim konkret për rekomandimet e propozuara. Propozoj që pasuri i parë që është „ Komisioni i përkrah kërkesat e punëtorëve shëndetësore për rritje të pagave dhe për miratimin e Ligjit për sigurime shëndetësore dhe Ligjit të punës” të del në pjesën mbi rekomandim dhe të mos jetë pjesë e rekomandimit. Pajtohem edhe me propozimin që të fshihet fjalia „ *brenda mundësive buxhetore*”. Gjithashtu pajtohem që pika katër të jetë dhe të kërkohej nga qeveria që të punoj me seriozitet në hartimin e ligjeve por kam propozuar që kjo pikë të plotësohet me këtë përmbajtje,, Të sillen në Kuvend në kohën e paraparë sipas strategjisë legjislative projektligjet e zbatueshme për punën dhe projektligjin për sigurime shëndetësore”

Rita Hajzeraj – Pasi është kërkesë e sindikatës së QKUK- së dhe është trajtuar edhe në komision , mendoj se duhet të jetë edhe rekomandimi i 4 që ka të bëjë me ligjet. Edhe vitin e kaluar këto dy ligje kanë qenë në strategjinë legjislative por nuk kanë ardhur në Kuvend. Ndërsa lidhur me pikën 4 që e propozoj Qamilja mendoj se të gjitha ligjet që miratohen në Kuvend duhet të jen të zbatueshme dhe nuk ka nevojë të ceket në rekomandim. Sa i përket statusit të QKUK së këtë kërkesë Komisioni nuk e ka trajtuar në mbledhjen e kaluar prandaj nuk ka nevojë të jetë pjesë e rekomandimit. Një pasus për reformat shëndetësore që janë të domosdoshme ndoshta mund të jetë pjesë e këtyre rekomandimeve.

Teuta Hadri – Unë propozova që ti japim përparësi kërkesës për rritje të paga , ndërsa procedura e miratimit të ligjeve të kërkuara nga sindikata kërkon një kohë më të gjatë.

Sadik Idriz – Rekomandimi 4 është rekomandim i nevojshëm sepse sipas strategjisë këto ligje duhet të vinë në mars dhe ne nuk mund ti kërkojmë ma herët apo më vonë por kërkojmë të vinë sipas afatit të paraparë në strategji. Pajtohem me të gjitha rekomandimet ashtu si janë.

Duhet Qeveria të vazhdojë bisedimet me sindikatën , ndërsa ne jemi në përkrahje të kërkesave të punëtorëve shëndetësore.

Këto rekomandime janë një përkrahje për punëtorët shëndetësor dhe komisioni jon nuk ka fuqi tjetër .

Flora Brovina – Mendoj se pjesëmarrja e ministrave në mbledhje është pjesëmarrje e Qeveris dhe nuk mund të themi se nuk ka qenë interesimi i Qeveris për këtë çështje. Pajtohem që patjetër të jetë rekomandimi i 4 që ka të bëjë me nxjerrjen e ligjeve sepse kjo është puna kryesore e jona, nxjerrja e ligjeve.

Qamile Morina – Ne e dimë se fuqia e Komisionit nuk është ekzekutive por mendoj se rekomandimet janë mjaft serioze duke pasur parasysh situatën shumë të rënd në shëndetësi. Edhe një herë propozoj që rekomandimi i parë të kalojë në pjesën hyrëse dhe të mos jetë pjesë e rekomandimeve.

Gjylnaze Sylja – Çështja në shëndetësi është e rënd dhe mendoj se në mbledhjen e kaluar do të duhet të ishte prezent edhe zëvendëskryeministri Kuqi, pasi kjo çështja kërkon zgjidhje më të gjer dhe nuk është në kompetencë vetëm të ministrisë së shëndetësisë. Rritja e pagave ka implikime buxhetore dhe buxheti menaxhohet nga Qeveria

Në rekomandimin e 4 propozoj që te fjala strategjia legjislative të precizohet „ *e vitit 2010*”.

Sadik Idriz – Çështja e pagave të punëtorëve shëndetësor do të diskutohet në Qeveri dhe Qeveria do të vendos. Nuk është me rëndësi pse nuk ka qenë në mbledhje prezent zëvendëskryeministri Kuqi.

Nga diskutimet e zhvilluara në këtë mbledhje, komisioni me konsensus të plot i përkrahu kërkesat legjitime të punëtorëve shëndetësorë dhe Qeveris së Kosovës i drejtohet me këtë :

REKOMANDIM

1. Kërkohet nga Qeveria e Kosovës që në bashkëpunim me ministrin përkatës të gjej një zgjidhje sa më të shpejt për plotësimin e kërkesave të punëtorëve shëndetësor .
2. Të bëhet rritja e pagave të punëtorëve shëndetësor ashtu si ju është premtuar.
3. Të sillen në Kuvend në kohën e paraparë sipas strategjisë legislative të vitit 2010, Ligji për punën dhe Ligji për sigurime shëndetësore.

7. Të ndryshme

Sadik idriz – Në mbledhjen e kaluar i kemi formuar grupet punuese për amendamentimin e ligjeve dhe këto grupe punues do të fillojnë me punë. Sa i përket ligjit për produkte medicinale , ka propozim që të mbahet një dëgjim publik por mendoj se grupi punues duhet ti rekomandoj Komisionit se a mendojnë se duhet të mbahet dëgjim publik dhe nëse po, ta propozojnë edhe listën e të ftuarve . Komisioni do të vendos datën e dëgjimit publik pas propozimit të grupit punues.

Flora Brovina – Mendoj se dëgjimi publik është i nevojshëm për këtë P/Ligj por grupi punues duhet të bëj përgatitjet e duhura për mbajtjen e dëgjimit publik.

Rita Hajzeraj – Mendoj që së pari të mbahet dëgjimi publik pastaj të fillojmë të punojmë në ligj dhe të shohim a ka nevojë të angazhohen edhe ekspert.

Gjylnaze Sylja - E shoh shumë të nevojshme mbajtjen e një dëgjimi publik dhe propozoj të jen të ftuar sa më shumë grupe të interesit.

Qamile Morina – Projektligji nuk është shumë i qartë prandaj kemi nevojë edhe për mendimin e ekspertëve.

Sadik Idriz – Ta mbajmë dëgjimin publik dhe të dëgjojmë nga të ftuarit se ku janë vërejtjet e tyre, pastaj do ta vazhdojmë punën tonë.

Teuta Hadri – pajtohem me propozimin e kryetarit që të mbajmë dëgjimin publik dhe ta përfundojmë punën tonë që ligji të miratohet në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sadik Idriz